



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 22.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ALBKOS INT" për aktivitetin: "Furnizimi, mirembajtja dhe servisimi i aparateve kunder zjarrit" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-7490-121** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "ALBKOS INT" e datës 22.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, mirembajtja dhe servisimi i aparateve kunder zjarrit" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-7490-121**, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 19.11.2019*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. **Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 19.11.2019;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**ABKOS INT**" me datë 22.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, mirembajtja dhe servisimi i aparateve kunder zjarrit" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-7490-121**. Autoriteti Kontraktues, me datë 26.11.2018 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi kryesor i parashtruesit te kerkeses eshte se tenderuesi i rekomanduar per dhenje te kontrates ka ndryshuar emertimin e pozicionit dhe se nuk ka permbushur Specifikacionet teknike te detyrueshme te tenderit, mungesa e te cilave kushtezon qe te mos dihet se çfare aparatesh furnizon (2,5,10 kg). Ky pretendim eshte plotesisht i pa bazuar, pasi qe ne tenderin e te rekomanduarit per kontrate ekziston Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga te dy anetaret e grupit se oferta e tyre eshte ne perputhje te plote me Aneksin 1-Specifikimet teknike te detyrueshme dhe nga kjo rrjedh se nuk ka kurrfare rreziku per furnizim me ndonje variant

tjeter perpos atij qe Autoriteti Kontraktues e ka specifikuar ne Aneksin 1.Per te qene te sigurte ne kete per shkak te mungeses se pershkrimit te plote te artikullit ne piken A 9 kjo do te kerkohet edhe nje here te konfirmohet para nenshkrimit te kontrates.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Shtojce:Deklarata e tenderuesit per Aneksin 1.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit


Grami shpk.

Adresa: Rruga. Xhorxh Bush, Nr. 16,
10000, Prishtine

&

Pastor Kosova shpk

Adresa: 28 nentori, Ll-2, Lok. 3/1
10000, Prishtine

DEKLARATE

Per

Aneksi 1

Per tenderin me,

Numri i Prokurimit: **616-19-7490-1-2-1**

Numri i brendshëm: **616 19 168 121**

Titulli: **Furnizimi, mirmbajtja dhe sevisimi i aparatave kunder zjarrit**

Deklarojme se oferta jone eshte ne perputhje te plote me Aneksi 1. – Specifikimet Teknike te detyrueshme te DT

Date, 27.10.2019

GRAMI shpk

Gramoz Ymeri, Drejtor



Pastor KosovaShpk

Latif Imeri, Drejtor

